



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr.20, datë 25.02.2021

PËR

MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 126 , DATË 24.12.2020 “ PËR LISTËN EMËRORE TË NXËNËSVE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR DHE KONVIKTEVE TË SHKOLLAVE TË MESME PROFESIONALE, QË PLOTËSOJNË KRITERET LIGJORE PËR PËRFITIMIN E BURSAVE DHE PAGESAVE PËR VITIN SHKOLLOR 2020-2021”

Në mbështetje të Ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 666, datë 10.10.2019 ”Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave dhe pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në Institucionet Arsimore Publike”, i ndryshuar, Urdhërit të Zëvendëskryetarit të Bashkisë Nr.349, datë 29.10.2020 “Për ngritjen e komisionit për shqyrtimin e kërkesave për përfitim burse për nxënësit dhe studentët në institucionet arsimore publike për vitin shkollor 2020-2021”, Urdhërit të Zëvendëskryetarit të Bashkisë Nr.350, datë 29.10.2020 “Për ngritjen e komisioneve pranë Shkollave të Mesme Profesionale Durrës për shqyrtimin e kërkesave për përfitim burse dhe pagesë për nxënësit në këto institucione arsimore publike për vitin shkollor 2020-2021”, Shkresës Nr.21839 prot., datë 23.11.2020 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, protokolluar në Bashkinë Durrës me Nr.14302 prot., datë 25.11.2020, Shkresës Nr.5564/33 prot., datë 20.11.2020 të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, protokolluar në Bashkinë Durrës me Nr.14499 prot., datë 02.12.2020, Shkresa e Bashkisë Durrës nr.877 prot, datë 22.01.2021, Urdhërit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë Nr.18, datë 2.2.2021 “Për miratimin e shtyrjes së afatit për miratimin e vendimeve për bursa të nxënësve të arsimit profesional në Këshillin Bashkiak Durrës”, si dhe sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Arsim, Kulturë, Rinisë, Sporteve dhe Komuniteteve Fetare, me propozim të Zëvendëskryetares së Bashkisë, e cila kryen funksionet e Kryetares së Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Miratimin e ndryshimit të pikës 1/A, përsa i përket listës së nxënësve të Shkollës së Mesme Teknologjike “Hysen Çela”, që përfitojnë bursë sipas parashikimeve të pikës 9 dhe 10 të VKM-së nr.666/2019, i ndryshuar, viti shkollor 2020-2021, duke shtuar nxënësit sipas tabelës si më poshtë vijon :

Nr.	Emër Mbiemër	Viti	Dega	Bursë	Kriteri përfitues
1.	Zenel Rakip Fasliu	Parë	Hoteleri	plotë	kriteri 2.3/d
2.	Enes Rexhep Ferra	Katër	Detari	plotë	kriteri 2.4/a
3.	Aleandros Agron Alia	Katër	Ekonomik	plotë	kriteri 2.1/a

2. Miratimin e ndryshimit të pikës 1/B, përsa i përket listës së nxënësve të Shkollës së Mesme Profesionale “Beqir Çela”, që përfitojnë bursë sipas parashikimeve të pikës 9 dhe 10 të VKM-së nr.666/2019, i ndryshuar, viti shkollor 2020-2021, duke shtuar nxënësit sipas tabelës si më poshtë vijon :

Nr	Emër Mbiemër	Viti	Dega	Bursa	Kriteri
1	Enes Beqir Idrizaj	parë	SHMT	plotë	2.3 dh + 20
2	Ermal Kanxha	parë	Termo-Hidraulik	plotë	2.1/a
3	Igli Fatmir Koci	dytë	SHMT	plotë	2.1 a
4	Osman Blerim Demarku	katër	Informatikë	plotë	2.3 d
5	Ziard Alfred Dushaj	katër	Elektromekanikë	plotë	2.1 a
6	Zeredin Alfred Dushaj	katër	Termo-Hidraulik	plotë	2.1 a

3. Miratimin e ndryshimit të pikës 2/A, përsa i përket listës emërore të nxënësve të Shkollës së Mesme Teknologjike “Hysen Çela”, kategoria “Nxënësit që ruajnë bursën” për shkak se plotësojnë kriteret ligjore për përfitimin e bursës sipas parashikimeve të VKM-së nr. 666/2019, i ndryshuar, për vitin e dytë e lart, viti shkollor 2020-2021, duke shtuar nxënësit sipas tabelës si më poshtë vijon:

Nr.	Emër Mbiemër	Viti	Dega	Bursa	Kriteri bursës
5.	Suada Gege Marku	dytë	Hoteleri	plotë	kriteri 2.4/b
10.	Eli Gëzim Disha	dytë	Hoteleri	plotë	kriteri 2.3/d
22.	Albi Gëzim Xhixha	tretë	Hoteleri	plotë	Kriteri 2.3/d
24.	Albino Nikolin Gega	katër	Detari	plotë	Kriteri 2.4/a
27.	Fabricio Orgen Malo	katër	Detari	plotë	Kriteri 2.4/a

4. Miratimin e ndryshimit të pikës 2/B përsa i përket listës emërore të nxënësve të Shkollës së Mesme Profesionale “Beqir Çela”, kategoria “Nxënësit që ruajnë bursën” për shkak se plotësojnë kriteret ligjore për përfitimin e bursës sipas parashikimeve të VKM-së nr. 666/2019, i ndryshuar, për vitin e dytë e lart, viti shkollor 2020-2021, duke shtuar nxënësit sipas tabelës si më poshtë vijon:

Nr.	Emër Mbiemër	Viti	Bursë	Kriteri përfitues
1.	Kristi Sabri Kuriqi	Katër	plotë	kriteri 2.1/a
13.	Ylber Artan Loci	Dytë	plotë	kriteri 2.1/a

5. Miratimin e ndreqjes së gabimeve me karakter material përsa i përket korrigjimit të mbiemrit të nxënësit të Shkollës së Mesme Profesionale “Beqir Çela”, përfitues i bursës për vitin e parë, i pozicionuar i 16-të nga Klevis Haki Hyka në Klevis Haki Hysa.
6. Miratimin e ndreqjes së gabimeve me karakter material përsa i përket korrigjimit të kriterit të përcaktuar për përfitim burse në VKM-në nr.666/2019, i ndryshuar, nga 2.3/f në 2.3/g, në listat emërore të nxënësve që përfitojnë bursë për vitin shkollor 2020-2021 në Shkollën e Mesme Teknologjike “Hysen Çela”, në Shkollën e Mesme Profesionale “Beqir Çela” dhe në Shkollën e Mesme Sportive “Bernardina Qeraxhi”.
7. Miratimin e ndreqjes së gabimeve me karakter material përsa i përket korrigjimit të kriterit të përcaktuar për përfitim burse në VKM-në nr.666/2019 i ndryshuar, nga 2.1/a në 2.2, në listën emërore të nxënësve që përfitojnë bursë për vitin shkollor 2020-2021 të Shkollës së Mesme Profesionale Kombëtare “Charles Telford Ericson”, Golem Kavajë.

8. Miratimin e ndreqjes së gabimeve me karakter material përsa i përket përfshirjes në më shumë se një listë emërore të nxënësit Mariglen Andi Ismailaj dhe nxënëses Eneida Partizan Kala si më poshtë vijon:
- Nxënësi Mariglen Andi Ismailaj hiqet nga tabela 2/A pika “Nxënësit, që i jepet bursë pasi kanë paraqitur dokumentacionin dhe plotësojnë kriteret e VKM nr.666/2019, të ndryshuar”, pasi është në tabelën 2/A “Nxënës që ruajnë bursën”
 - Nxënësja Eneida Partizan Kala hiqet nga tabela 2/C “Nxënës që humbasin bursën” të Shkollës së Mesme Sportive “Benardina Qerraxhi”, pasi është në tabelën 2/A “Nxënës që ruajnë bursën” Shkollës së Mesme Teknologjike “Hysen Çela” .
9. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Arsim, Kulturë, Rinisë, Sporte e Komunitete Fetare dhe Qendra Ekonomike e Arsimit.
10. Ky vendim llyr në fuqi 10 ditë mbas shpalljes (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).

KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 25.02.2021




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 143 prot.
3

Durrës, më 02.03.2021



Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit



KËSHILLIT BASHKIAK

DURRËS

Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr. 20 datë 25.02.2021 Për miratimin e disa ndryshimeve në Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr. 126 datë 24.12.2020 “Për listën emërore të nxënësve të arsimit parauniversitar dhe konvikteve të shkollave të mesme profesionale që plotësojnë kriteret ligjore për përfitimin e bursave dhe pagesave për vitin shkollor 2020-2021”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

